



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES  
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

---

# RAPORTI VJETOR I PUNËS 2011



**TË DHËNAT U PËRGATITEN NGA DPPM**  
*TIRANË, Janar 2011,*

## **PËRMBAJTJA**

*I-AKTIVITETE TË DREJTORISË NË LIDHJE ME ZBATIMIN E ANGAZHIMEVE NË KUADËR TË MSA-SË.....*

- 1. INICIATIVA LIGJORE*
- 2. PROMOVIMI I TË DREJTAVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE*
- 3. INSTITUCIONET E ZBATIMIT TË TË DREJTAVE TË PI, BASHKËPUNIMI NDËRMJET TYRE DHE STRATEGJIA E PRONËSISË INTELEKTUALE.*
- 4. PUBLIKIMET PERIODIKE TË DPPM DHE FAQJA E INTERNETIT*

*II- AKTIVITETE TE TJERA TE DPPM*

- 1. PROGRAMI IPA 2009*
- 2. NËNSHKRUHET MEMORANDUMI BASHKËPUNIMIT NDËRMJET DPPM-SË DHE ZYRËS SË PRONËSISË INDUSTRIALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.*
- 3. PRESIDENTI I EPO-S Z. BENNOIT BATTISTELLI, VIZITON SHQIPËRINË*

*III-DETYRAT FUNKSIONALE TË REALIZUARA SIPAS SEKTORËVE.....*

- 1- SEKTORI I EKZAMINIMIT TË PATENTAVE DHE MODELEVE TE PERDORIMIT....*
- 2- SEKTORI I EKZAMINIMIT TË MARKAVE DISENJOVE DHE TREGUESVE GJEOGRAFIKE.....*
- 3- SEKTORI JURIDIK DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË.....*
- 4-SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT.....*
- 5- SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE DHE FINANCËS.....*

## **I. AKTIVITETE TË DREJTORISË NË LIDHJE ME ZBATIMIN E ANGAZHIMEVE NË KUADËR TË MSA-SË**

DPPM, për vitin 2011, ka punuar për të realizuar të gjitha detyrat funksionale në ngarkim të saj. Raporti i punës për vitin 2011 ndahet në dy pjesë. Në pjesën e parë paraqiten të gjitha detyrat e realizuara në zbatim të detyrimeve të MSA si dhe rekomandimeve të Raport - Progresit të BE 2010 dhe në pjesën e dytë paraqitet realizimi i detyrave funksionale të ndara sipas sektorëve.

Për përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga MSA dhe të rekomandimeve të Raport - Progresit të BE 2010, në fushën e Pronësisë Industriale në lidhje me zbatimin e iniciativave ligjore dhe aktiviteteve zbatuese është punuar në drejtimet e mëposhtme:

### ***1. Iniciativa ligjore***

#### ***2. Promovimi i të drejtave të Pronësisë Industriale***

#### ***3. Institucionet e zbatimit të të drejtave të PI, bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe strategjia e Pronësisë Intelektuale.***

#### ***4. Publikimet periodike të DPPM dhe faqja e internetit***

### **1. Iniciativa Ligjore**

Në lidhje me zbatimin e Iniciativave Ligjore të parashikuara në Planin Kombëtar për zbatimin e MSA-së si dhe të rekomandimeve të Raport- Progresit të BE gjatë vitit 2011, DPPM ka realizuar si më poshtë:

- Në datë 15 Korrik 2011 ka hyri në fuqi Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 433 datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 për tarifën e regjistrimit të objekteve të Pronësisë Industriale".

- Në datë 07.09.2011 është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 618 për disa ndryshime në VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave të shpikjeve" dhe ka hyrë në fuqi më datë 12 Tetor 2011. Ndryshimet në rregulloren e patentave kanë si qëllim harmonizimin e disa procedurave kombëtare me procedurat e parashikuara nga Konventa Evropiane e Patentave dhe Traktati i Ligjit për Patentat.

- Projektligji për disa ndryshime në Kodin Penal të RSH (iniciativë e Ministrisë së Drejtësisë) i cili parashikon sanksione penale për shkeljen e të drejtave të Pronësisë Industriale në përputhje me marrëveshjen e TRIPS-it pritet të miratohet nga parlamenti.

- Në muajin Korrik 2011 hyri në fuqi Ligji Nr. 10433 datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në RSH". Miratimi i këtij ligji është pjesë e reformës së qeverisë për rregullimin e sistemit të inspektimit në Shqipëri dhe për pasojë do të ndikojë edhe në bazën ligjore të mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale. Institucionet përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji janë Këshilli i Ministrave dhe Ministrinë sipas fushën së aktivitetit që ato mbulojnë. Dispozitat lidhur me inspektimin e zbatimit të të drejtave të Pronësisë Industriale do t'i propozohen Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga DPPM sapo të fillojë procesi i hartimit të akteve nënligjore.

## **2. Promovimi i të drejtave të Pronësisë Industriale**

Promovimi i Pronësisë Industriale ka qenë një ndër prioritet e punës së DPPM-së për vitin 2011.

- Gjatë muajve Shtator-Tetor 2011, Drejtori i Përgjithshëm i DPPM, me qëllim promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut të gjerë lidhur me mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale, dha disa intervista për kanalet televizive shqiptare, tematika e të cilave ishte sistemi i mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri.

- Grupi i projektit IPA 2009 së bashku me koordinatorin e DPPM për projektin, zhvilluan gjatë muajit qershor takime me përfaqësues të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, ku u diskutua për ngritjen e qendrës së informacionit në ambientet e tyre.

Një takim u zhvillua gjithashtu me përfaqësues të Fakultetit të Drejtësisë për të diskutuar lidhur me përmirësimin e programit mësimor dhe materialeve mësimore në fushën e të drejtave të PI.

-Ngritja e Qendrës së Informacionit Teknik dhe Shkencor në Tiranë e parashikuar në Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale do të shërbejë si pikë kyce për promovimin e të drejtave të PI dhe rritjen e ndërgjegjësimit të stafit akademik, studentëve, qarqeve të biznesit dhe publikut të gjerë lidhur me nevojën e mbrojtjes së të drejtave të PI. Kjo qendër është parashikuar të krijohet me asistencën teknike dhe financiare të projektit IPA 2009 dhe të jetë funksionale brenda muajit Dhjetor 2012.

### **3. Institucionet e zbatimit të të drejtave të PI, bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe strategjia e PI.**

Në kuadrin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të zbatimit të të drejtave të PI gjatë vitit 2011 janë zhvilluar takimet e mëposhtme:

- Më datë 16 Shtator 2011 është zhvilluar takimi i parë i përfaqësuesve të institucioneve të përfshira në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2010-2015. Qëllimi i takimit ishte të diskutohej lidhur me arritjet dhe problemet e hasura në 6-mujorin e parë pas hyrjes në fuqi të Strategjisë.

- Më datat 14-15 Tetor 2011 është zhvilluar konferenca e parë në Shqipëri për Bashkëpunimin Ndërkombëtar mbi Substancat e Rrezikshme dhe Sigurinë e Produkteve në Ballkan ku nga përfaqësuesi i DPPM është mbajtur një prezantim lidhur me rolin e DPPM dhe rëndësinë që ka zbatimi i legjislacionit shqiptar për të Drejtat e Pronësisë Industriale në mbrojtjen e konsumatorit.

- Më datë 22 Nëntor 2011, Drejtori i Përgjithshëm i DPPM mori pjesë në Konferencën mbi zbatimin e legjislacionit shqiptar për Pronësinë Intelektuale, zhvilluar nga Dhoma Amerikane e Tregtisë, ku merrnin pjesë përfaqësues nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e të drejtave të Pronësisë Intelektuale në Shqipëri si dhe nga qarqet e biznesit. Prezantimi i Drejtorit të Përgjithshëm të DPPM kishte si qëllim promovimin e rëndësisë së mbrojtjes së të drejtave të Pronësisë Industriale si dhe venien e theksit në rolin që luan DPPM për të siguruar mbrojtjen e këtyre të drejtave dhe në dhënien e mbështetjes për institucionet direkt përgjegjëse për zbatimin e tyre.

- Grupi i projektit IPA 2009 së bashku me koordinatoren e DPPM për projektin zhvilluan gjatë muajit Qershor takime me përfaqësues të Policisë së Krimit Ekonomik, Prokurorisë, Drejtorisë së METE për Mbikqyrjen e Tregut, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Shkollës së Magjistraturës.

Qëllimi i takimeve ishte prezantimi i projektit IPA 2009 dhe krijimi i themelit të nevojshëm të bashkëpunimit midis këtyre institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale.

- Kalendarin për zhvillimin e trajnimeve për gjyqtarët e cështjeve të PI dhe stafin e policisë, prokurorisë dhe doganave të përfshira në zbatimin e të drejtave të PI është duke u përgatitur nga grupi i projektit IPA dhe është pjesë e planit të veprimit të projektit. Ky kalendar do të fillojë të zbatohet në vitin 2012.

#### **4. Publikimet periodike të DPPM dhe faqja e internetit**

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2011, DPPM ka publikuar Buletinin e Pronësisë Industriale i cili përmban informacione për publikun mbi aplikimet për patenta për shpikje, patenta të lëshuara, aplikimet për dizeno industriale, marka të depozituara, emërtime origjine të regjistruara, marka të regjistruara, marka të ripërtërira. Nga muaji Janar deri në muajin Qershor 2011 publikimet janë bërë cdo muaj duke publikuar gjithsej 5 buletine. Duke filluar nga muaji Gusht deri në Dhjetor publikimi i buletinit është bërë një herë në dy muaj për markat tregtare dhe të shërbimit dhe cdo muaj për patentat e shpikjeve dhe gjithsej janë publikuar 3 buletine për markat dhe 5 për patentat. Në total për gjithë vitin 2011 janë publikuar 13 buletine për objektet e PI. Për herë të parë DPPM publikoi një buletin me patentat e skaduara.

Totali i rekordeve të publikuara gjatë vitit 2011 arrin në 3759 rekorde.

Faqja e internetit të DPPM, [www.alpto.gov.al](http://www.alpto.gov.al), është një burim i rëndësishëm informacioni për personat të cilët janë të interesuar të aplikojnë për regjistrimin e objekteve të PI. Nëpërmjet saj, DPPM informon publikun në lidhje me aktivitetet dhe shërbimet që ajo kryen, në lidhje me legjistracionin në fushën e PI, rreth objekteve të PI (patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë).

Faqja e internetit përmban informacionin mbi mënyrën e aplikimit për secilin nga objektet e PI. Nëpërmjet faqes së internetit aplikuesit mund të hyjnë direkt në faqen e internetit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe të bëjnë kërkime on-line mbi markat e regjistruara nëpërmjet Marrëveshjes së Madridit.

#### **II. Aktivitete te tjera**

##### **1- Nënshkruhet Memorandumi Bashkëpunimit ndërmjet DPPM-së dhe Zyrës së Pronësisë Industriale të Republikës së Kosovës.**

Në 07 Dhjetor 2011, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe markave dhe Zyra e Pronësisë së Kosovës nënshkruan një memorandum bashkëpunimi me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e të drejtave të PI, për të siguruar një mbrojtje efektive të këtyre të drejtave sipas standarteve ndërkombëtare, për të përfaqësuar interesat e perdoruesve në një aspekt më të gjërë, për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik duke inkurajuar punën krijuese dhe shpikjet në të dy vendet.

Objektivi i këtij memorandumi është të sigurojë mbrojtje efektive dhe të forcojë bashkëpunimin në fushën e PI ndërmjet dy Zyrave.

Bashkëpunimi do të përqendrohet në këto drejtime kryesore:

- Shkëmbim informacioni në fushën e PI,
- Trajnimin e personelit të të dy Zyrave,
- Shkëmbimin e publikimeve, eksperiencave,
- Aktivitete të përbashkëta që kanë qëllim ndërgjegjësimin e publikut në fushën e PI,
- Ndihmë në implementimin e bazës të të dhënave, etj.

### **Programi IPA 2009**

Programi IPA 2009 “Zhvillimi i Sistemit të të Drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri” parashikon në planin e veprimit të tij, veprime specifike lidhur me forcimin e kapaciteteve administrative të DPPM përfshirë: trajnime për specialistët e DPPM, disenjimi dhe mbështetja në instalimin e infrastrukturës teknike të nevojshme për të siguruar një mjedis të sigurt të IT dhe përmirësimin e shërbimeve on-line si dhe hartimi i udhëzuesve (manualeve) për ekzaminimin e patentave, markave dhe disenjove industriale.

Programi IPA 2009 është aktualisht në fazën initiale. Në fillim të muajit Gusht drejtuesi i grupit të zbatimit të projektit ka paraqitur projekt-raportin inicial të programit, zbatimi i të cilit pritet të fillojë në muajin Shtator.

Në kuadër të mbështetjes që Programi IPA 2009 “Për zhvillimin e sistemit të Pronësisë Industriale në Shqipëri” po u ofron institucioneve shqiptare përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale dhe vecanërisht për harmonizimin e plotë të legjislacionit shqiptar në këtë fushë me acquis, janë planifikuar iniciativat e mëposhtme ligjore:

- Përgatitja e projektligjit për aderimin e Shqipërisë në Marrëveshjen e Londrës për patentat evropiane është parashikuar të përfundojë brenda vitit 2011 ndërsa miratimi i tij në parlament dhe aderimi në marrëveshje është parashikuar të ndodhë gjatë vitit 2012.
- Përgatitja e projektligjit për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” dhe në Ligjin Nr. 8488 dated 13.05.1999 “Për mbrojtjen e topografisë së qarqeve të integruara” me qëllim harmonizimin e plotë të tyre me acquis (bazuar në analizën e mangësive në legjislacionin e pronësisë industriale krahasuar me acquis mbështetur nga IPA 2008) është planifikuar të fillojë në Nëntor 2011 dhe të përfundojë në Qershor 2012.

Në kuadër të përmbushjes së aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të projektit, me qëllim forcimin e kapaciteteve administrative të DPPM janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme zbatuese:

- më datë 3 Nëntor 2011 është zhvilluar në Tiranë një workshop mbi Marrëveshjen e Londrës për patentat evropiane, ku stafi i DPPM është informuar lidhur me parashikimet dhe mënyrën e zbatimit të marrëveshjes.
- në datat 7-9 Nëntor 2011 është organizuar një study-visit në Zyrën e Pronësisë Industriale të Portugalisë për stafin drejtues të DPPM.

### **3. Vizita e Presidentit të EPO-s Z. Bennoit Battistelli, viziton Shqipërinë**

**Presidenti i EPO-s Z. Bennoit Battistelli, viziton Shqipërinë**, për herë të parë pas antarësimit të Shqipërisë në EPO në 1 Maj 2010.

Kryeministri Berisha priti në dt. 09.Shkurt 2011, në takim delegacionin nga Zyra Europiane e Patentave, të kryesuar nga Presidenti i saj Benoit Battistelli, të shoqëruar edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Patentave dhe Markave Z. Safet Sula.

Zoti Battistelli, pasi falënderoi Kryeministrin për kohën dhe interesin e dedikuar, i shprehu në emër të zyrës që ai kryeson, kënaqësinë për bashkëpunimin me Shqipërinë, si anëtarja më e re e këtij organizmi shumë të rëndësishëm të Bashkimit Europian. Numri i vendeve është 38, tha zoti Battistelli, por numri i anëtarëve si individë është me miliona. Është hera e parë, u shpreh më tej ai, që vizitoj Shqipërinë dhe u impresionova me atë ç'ka pashë.

Zoti Battistelli e konsideroi të rëndësishme hyrjen e Shqipërisë në këtë organizëm, duke shprehur besimin se duke punuar së bashku do të prezantojmë standardet evropiane të pronësisë industriale dhe intelektuale edhe në Shqipëri. Zoti Battistelli tha se Shqipëria si anëtarja më e re e këtij organizmi do të ketë rolin e saj në strukturat e Zyrës Europiane të Patentave.

Kryeministri shprehu besimin se përfitimet e antarësimit në këtë organizëm evropian janë të shumanshme. Kryeministri theksoi se qeveria do të mbështesë pa rezerva e me prioritet zhvillimin e kësaj Zyre dhe realizimin e objektivave të saj, si dhe bashkëpunimin e Zyrës shqiptare me Zyrën Europiane të Patentave, në drejtim të formimit të ekspertëve publikë e privatë, të zhvillimit të kapaciteteve teknike dhe prezantimit të standardeve evropiane në modernizimin e funksionimit të saj.



Pas takimit më Kryeminsitrin Berisha, Z. Battistelli pati një takim edhe me kryetarin e Delegacionit European në Shqipëri Z. Ettore Sequi.

Takimet e mësipërme u mbyllën më konferencën për shtyp të zhvilluar në Hotel Rogner, ku Z. Benoit Battistelli, Z. Edmond Hoxha, Zv. Ministër i Integritimit, Z. Safet Sula Drejtor i Përgjithshëm i DPPM, dhe Z Ettore Sequi kryetar i delegacionit evropian në Shqipëri, prezantuar Strategjinë Kombëtare e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale, 2010-2015.

Takimet e ditës së mërkurë të Z. Battisteli vijuan me vizitën në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, ku pati edhe takime me stafin e saj.


Në Dt. 10 Shkurt Z. Battistelli, zhvilloi një takim me Z. Nasip Naço, Ministër i Ekonomisë tregtisë dhe Energjetikës, i cili konfirmoi dhe garantoj edhe njëherë bashkëpunimin dypalësh ndërmjet EPO-s dhe Qeverisë Shqiptare. Ky takim mbylli edhe vizitën e Z. Battistelli në Tiranë.

## **II. DETYRAT FUNKSIONALE SIPAS SEKTOREVE**

### **1. SEKTORI I EKZAMINIMIT TE PATENTAVE DHE MODELEVE TE PERDORIMIT.**

Sektori i ekzaminimit të patentave dhe modeleve të përdorimit ka mbuluar të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë e cila ka të bëjë me regjistrimin dhe administrimin e patentave të shpikjeve dhe modeleve të përdorimit. Nga ky sektor lëshohen të gjitha ekstraktet e regjistrit dhe kryhen hetime sipas kërkesave të aplikuesve për të gjitha aplikimet per patenta .

**Për patentat e shpikjeve** në vitin 2011 janë depozituar **354** aplikime te reja për patentë, nga të cilat **344** kanë qenë kërkesa për shtrirje të Patentave Europiane , **5** aplikime për Patenta Kombëtare, dhe **5** aplikime PCT. Gjithashtu gjatë këtij viti zyra ka funksionuar për herë të parë si zyrë përcjellëse për në WIPO, pasi për herë të parë është përcjellë nëpërmjet zyrës sonë një aplikim ndërkombëtar PCT në WIPO.



Grafiku i mësipërm tregon numrin e aplikimeve për patentë shpikje të depozituar në DPPM nga viti 1993 deri në 2011

Gjatë vitit 2011 janë lëshuar **347** dëshmi depozitimi nga **330** që janë lëshuar vitin e kaluar, janë lëshuar **99** njoftime për plotësim formalitetesh të aplikimeve për patenta nga **58** që janë lëshuar vitin e kaluar, nga të cilat: **10** janë refuzuar për t'u grantuar për mosplotësim të dokumentacionit në afatin e caktuar . Gjithashtu janë lëshuar **440** patenta për shpikje nga **341** qw janë lëshuar nw vitin e kaluar.

Janë egzaminuar dhe pranuar **1759** ripërtëritje patentash nga **1506** qw janë egzaminuar nw vitin e kaluar vitin e kaluar ndërsa **176** patenta patenta janë egzaminuar dhe u është dhënë statusi skaduar për arsye të mospagesës së tarifës përkatëse për ripërtëritje të patentës nga **203** patenta qw janë skaduar nw vitin e kaluar.

Gjithashtu janë shqyrtuar **7** raste për rivendosje në afat të patentave /aplikimeve për patente nga te cilat janë rivendosur në afat **6** prej tyre dhe një është refuzuar

Në vitin 2011 numri i aplikimeve të depozituara për egzaminim në sektorin e patentave ka qenë në total **2461** aplikime të cilat janë paraqitur në mënyrë më të detajuar në tabelën e mëposhtme :

**APLIKIME TE DEPOZITUARA NE DPPM PER EGZAMINIM NE SEKTORIN E PATENAVE**

<b>Aplikime per patente shpikje</b>	<b>354</b>
<b>Aplikime per model perdorimi</b>	<b>0</b>
<b>Aplikime për ripërtëritje patente</b>	<b>1951</b>
<b>Aplikime për ndryshim pronësie</b>	<b>26</b>
<b>Aplikime për ndryshim emri</b>	<b>49</b>
<b>Aplikime për ndryshim adrese</b>	<b>10</b>

<b>Aplikime për ndryshime në pretendime</b>	<b>10</b>
<b>Aplikime për çertifikate te mbrojtjes shtesë</b>	<b>2</b>
<b>Hetime patente</b>	<b>50</b>
<b>Aplikime për rivendosje në afat</b>	<b>9</b>
<b>Totali</b>	<b>2461</b>

Gjate këtij viti është përballuar një volum i madh i pune dhe është pare një angazhim i madh nga ana e stafit për realizimin e detyrave të mara përsipër vitin e kaluar duke i realizuar ato plotësisht.

Tabela e mëposhtme jep në mënyrë më të detajuar dokumentat e leshuara nga sektori i patentave

<b>Dokumenta te leshuara nga sektori i Patentave</b>	<b>NR</b>
<b>Deshmi depozitimi</b>	347
<b>Njoftime ne file examination</b>	2
<b>Njoftim per plotesim formalitetesh</b>	99
<b>Ftese per pagese per leshimin e patentes</b>	29
<b>Ndryshim Emri</b>	20
<b>Ndryshim Adrese</b>	11
<b>Ndrysim Pronari</b>	26
<b>Ndryshime ne pretendime</b>	14
<b>Njoftim per mbajtje ne fuqi</b>	1759
<b>Patenta Europiane te Lëshuara</b>	416
<b>Patenta PCT dhe kombetare</b>	23
<b>Doreheqje patentash</b>	1
<b>Refuzim ne file exam</b>	0
<b>Refuzime per mospagese reg</b>	6
<b>Refuzim ne form exam</b>	4
<b>Pavlefshmeri e patentes per mospagese te mbajtjes ne fuqi</b>	176
<b>Njoftim hetimi per patente</b>	42
<b>Dublikate patente</b>	0
<b>Ekstrakt Patente</b>	5
<b>Certifikata te mbrojtjes shtese</b>	12
<b>Rikthim I te drejtave te patentes</b>	6
<b>Refuzim I kerkeses per rikthimin e te drejtave te patentes</b>	1
<b>Njoftim plotësim doc. per mbajtje ne fuqi te patetes/ ndryshime</b>	117
<b>Totali</b>	<b>3116</b>

Gjatë këtij viti kemi arritur të minimizojmë kohën për shtrirjen e Patentave Europiane nga 7 muaj ne 3-4 muaj duke zbatuar njekohesisht te gjitha procedurat administrative për leshimin e patentave, duke siguruar cilësi të lartë dhe shërbim të shpejte për të gjithë aplikantët gjatë procesit të egzaminimit.

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregon fluksin e aplikimeve kryesore që kanë hyrë dhe kanë dalë nga sektori i patentave gjate ketij viti .

<b>Aplikime për Patenta</b>	<b>Hyrje ne DPPM</b>	<b>Dalje nga DPPM</b>
<b>Viti</b>	<b>2011</b>	<b>2011</b>
<b>Aplikime për patentë</b>	<b>354</b>	<b>440</b>
<b>Ndryshim pronesie /emri/adrese</b>	<b>85</b>	<b>57</b>
<b>Ndryshim ne pretendime</b>	<b>10</b>	<b>14</b>
<b>Aplikime per ripertertje</b>	<b>1951</b>	<b>1759</b>
<b>Aplikime për SPC</b>	<b>2</b>	<b>12</b>
<b>Hetim patente</b>	<b>50</b>	<b>42</b>





Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë numrin e aplikimeve për patenta dhe patentat e lëshuara në vitet 2000-2011. Siç vëhet re ka një ngritje të lehtë të numrit të aplikimeve për patentë ; nga 341 që ishin vitin e kaluar në 354 në këtë vit.

VITI	Aplikime për patenta	Patenta të lëshuara
2000	63	6
2001	120	49
2002	238	87
2003	392	201
2004	420	390
2005	386	395
2006	426	116
2007	367	420
2008	377	541
2009	361	402
2010	341	348
2011	354	439



Gjatë vitit 2011 nga ky sektor është punuar dhe në drejtime të tjera si:

- 1- Trainimi i stafit për adaptimin me rregulloren e re të patentave .
- 2- Sektori ka bashkepunuar me Zyrën Europiane të Patentave dhe Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale në raportimin rregullisht të statistikave dhe plotësimin në kohë të pyetësorëve të kërkuara për patentat e shpikjeve.
- 3- Paisja me bazë materiale dhe logjistike e Sektorit të Patentave
- 4- Stafi i sektorit ka marrë pjesë në takime si edhe në trajnime të organizuara nga EPO.

## **2. SEKTORI I EKZAMINIMIT TË MARKAVE TREGTARE DHE TË SHERBIMIT, DIZENJOVE INDUSTRIALE DHE TREGUESEVE GJEOGRAFIKE**

Sektori i ekzaminimit të markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë për vitin 2011 ka mbuluar të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë e cila ka të bëjë me regjistrimin e aplikimeve të objekteve të Pronësisë Industriale si markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë. Nga ky sektor lëshohen të gjitha ekstraktet e regjistrimit dhe kryhen hetime sipas kërkesave të aplikuesve për të gjitha objektet e PI të lartpërmendura.


Gjatë vitit 2011 janë depozituar 1057 aplikime për marka nga 928 aplikime të depozituara në vitin 2010. Nga këto aplikime 337 janë ripërtëritje marke të depozituara në vitin 2011 nga 318 aplikime për ripërtëritje marke të depozituara në vitin 2010.

Gjatë vitit 2011 janë lëshuar 934 çertifikata regjistrimi marke nga 866 çertifikata regjistrimi marke të lëshuara në vitin 2010. Nga këto çertifikata 367 janë çertifikata ripërteritje marke të lëshuara në vitin 2011, nga 272 çertifikata ripërteritje marke të lëshuara në vitin 2010.


Siç shihet nga të dhënat gjatë vitit 2011 pranë DPPM janë depozituar 129 aplikime më shumë se në vitin 2010 e shprehur në përqindje 12.2% më shumë në 2011 se në 2010, ndërsa janë lëshuar 68 çertifikata regjistrimi më shumë se në vitin 2010 ose 7.28%.

Aplikimet nga subjektet shqiptare në 2011 kanë arritur në 257 aplikime e shprehur në përqindje 35% e numrit total të aplikimeve të depozituara në vitin 2011.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i aplikimeve, regjistrimeve dhe ripërtëritjeve në vite.




Nëse do të krahasojmë numrin e aplikimeve me numrin e regjistrimeve të kryera gjatë vitit 2011 aplikimet zënë (53%) dhe rregjistrimet (47%).



Nga sektori i markave gjatë vitit 2011 janë lëshuar: 625 dëshmi depozitimi dhe janë publikuar; për 422 aplikime janë lëshuar njoftime për plotësim defektësh dhe formalitetësh, 596 ftesa për pagesë regjistrimi, janë ekzaminuar 131 aplikime për ndryshime në pronësi dhe 232 ndryshime në emër dhe adresë, janë lëshuar 567 çertifikata regjistrimi, 367 çertifikata regjistrimi ripërtëritje, dhe 1 dorëheqje nga marka.

Në total gjatë vitit 2011 nga ky sektor janë lëshuar 5603 dokumenta nga 3591 dokumenta të lëshuara gjatë vitit 2010. Këto të dhë tregojnë një rritje të punës së realizuar nga ky sektor gjatë vitit 2011. Rol në këtë rritje kanë luajtur dhe veprimet që janë kryer me markat e Madridit.

<i>Dokumenta të lëshuara në vitin 2011</i>	<i>Nr. dokumentave</i>
Deshmi depozitimi	625
Njoftim plot form	422
Ftesë për pagesë reg	596
Certif. Reg	567
Ripërtëritje marke	367
Ndryshim Emri/adrese	242
Ndryshim Pronari	131
Refuzime për mospagesë reg	17
Refuzim ne form exam	15
Refuzim ne baza absolute	2
Kufizim I listës së mallrave	2
Doreheqje nga marka	1
Dublikata	29
Hetim marke	333
Ekstrakt Regjistri	356
Veprime me markat e Madridit	1808
Njoftim plotesim defektesh	6
Deshmi depozitimi disenjo	17
Certifikata regjistrim/riperteritje disenjo	17
Refuzim disenjo	1
Licenca marke	49
<b>TOTALI I DOKUMENTAVE TË LËSHUARA</b>	<b>5603</b>




Sic shihet nga grafiku volumi i punës i realizuar gjatë vitit 2011 zë 66% nga 34% e realizuar në vitin 2010.

Janë kaluar në sistemin IPAS 1553 veprime për dëshmitë e depozitimit dhe çertifikatat e regjistrimit, ndërsa janë kryer dhe veprimet e firmosjes së ftesave për pagesë regjistrimi dhe të gjithë dokumentave të tjera të lëshuara nga ekzaminueset si ndryshime pronësie, emri, adrese, njoftim plotësim formalitetesh etj të cilat nuk janë përfshirë në këtë shifër.



Volumi më i madh i punës së këtij sektori është realizuar në drejtim të kalimit në IPAS të veprimeve të markave të Madridit, lëshimit të certifikatave të regjistrimit, ftesave për pagesë regjistrimi, lëshimit të dëshmimeve të depozitimit dhe dokumentave të lëshuara për ndryshim pronësie, adrese dhe emri. Grafiku i mëposhtëm tregon një pjesë të dokumentave të lëshuara gjatë procesit të ekzaminimit në vitin 2011.



Gjatë këtij viti jemi përpjekur të minimizojmë kohën për zbatimin e procedurave administrative për markat, duke zbatuar me rigorozitet afatet ligjore. Qëllimi kryesor i punës është të sigurojmë cilësi të lartë dhe shërbime të shpejta për të gjithë aplikantët gjatë procesit të egzaminimit. Në tabelën e mëposhtme jepen dokumentat e depozituara në DPPM gjatë vitit 2011.

**DOKUMENTA TE DEPOZITUARA NE DPPM**

Kërkesa për regjistrim marke	720
Kërkesa për ripërtëritje marke	337
Kërkesa për ndryshim i emrit te pronarit	102
Kërkesa për ndryshimin e adresës se pronarit	129
Kërkesa për ndryshim pronari	150
Kërkesë për ekstrakt regjistri	364
Kërkesë për doreheqje marke	32
Kërkesë për mos rregjistrimin e markes se publikuar	40
Kërkesë për licencë	38
Kërkesë për regjistrim disenjo	17
Kërkesë për kufizim të listës së listës së mallrave	6
Kërkesë për dublikatë certifikate	30
Kërkesë për ripërtëritje disenjoje	5
Kërkesë për hetim marke	333
<b>Totali</b>	<b>2303</b>

Regjistrat e objekteve të pronësisë industriale për sektorin janë azhornuar përkatësisht me 1314 fletë regjistri, janë vendosur fletët e regjistrit për 363 ndryshime emri, ndryshime adrese dhe ndryshime pronësie, janë vendosur fletët e regjistrit të 367 ripërtëritjeve, për 567 çertifikata regjistrimi, 17 disenjo si dhe janë marre ne dorëzim 1161 dosje.


Gjatë vitit 2010 i është dhënë përgjigje 333 kërkesave për hetim marke përfshirë këtu (hetim në regjistrat kombëtare dhe ndërkombëtare), janë lëshuar 364 ekstrakte regjistri dhe 30 dublikata marke.

**Aplikimet nga Marrëveshja e Madridit**

Gjatë vitit 2011 janë rregjistruar 3973 aplikime nga Marrëveshja e Madridit nga të cilat 1241 janë aplikime për ripërtëritje markash.

Ne total në DPPM në vitin 2011 janë depozituar 5030 aplikime dhe ripërtëritje nga të cilat 3973 nga Marrëveshja e Madridit, 783 aplikime të huaja dhe 274 aplikime shqiptare. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë numrin e aplikimeve vendase, aplikimeve në rrugë kombëtare dhe aplikimeve nga Marrëveshja e Madridit, gjatë vitit 2011.

Viti	2010	2011
Aplikime shqiptare/Riperteritje	286	276
Aplikime ne rruge kombëtare nga aplikante te huaj/Riperteritje	642	781
Aplikime nga Marrëveshja dhe Protokolli i Madridit/Riperteritje	4029	3973
<b>TOTALI</b>	<b>4957</b>	<b>5030</b>



Sic shihet nga grafiku gjatë këtij viti kemi një ballancim të numrit të aplikimeve shqiptare, një rritje të aplikimeve kombëtare ( aplikime nga aplikantë të huaj të realizuara nëpërmjet rrugës kombëtare) dhe një ballancim të aplikimeve ndërkombëtare.

Gjithashtu siç shihet nga grafikët në total kemi një ballancim të numrit të aplikimeve në vitin 2011 në krahasim me vitin 2010 me një rritje të vogël në vitin 2011.

Gjatë vitit 2010 janë lëshuar 4 certifikata regjistrimi disenjosh industriale, 13 ripërtëritje disenjosh, 17 dëshmi depozitimi, 6 njoftime plotësim dokumentacioni, është bërë 1 refuzim disenjoje.

Në vitin 2010 janë depozituar 17 kërkesa për regjistrim disenjoje dhe 5 kërkesa për ripërtëritje disenjoje si dhe një kërkesë për regjistrim tregues gjeografik.

Gjate vitit 2011 nga ky sektor është punuar dhe në drejtime të tjera si:

- Janë hartuar progres raportet mujore në lidhje me aktivitetin e DPPM në zbatim të angazhimeve të MSA si dhe janë hartuar raportet 6- mujore të punës dhe raportet javore punës.

- Përgjegjësja e sektorit ka përfaqësuar DPPM në seminare të ndryshme ku dhe kanë diskutuar mbi legjislacionin e ri të DPPM-së, mbi markat dhe rëndësinë e tyre për ekonominë e tjerë.
- Është sistemuar arkiva e markave dhe disenjove si dhe është punuar dhe me arshivën e patentave.
- Përgatitja e raportit të progresit për vitin 2010 në fushën e Pronësisë Industriale në kuadër të Raportit për Politikën Tregtare të OBT.
- Stafi i sektorit ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me WIPO dhe EPO.
- Përgatitja e raportit vjetor të punës për vitin 2010 në lidhje me punën e sektorit dhe sistemimi i raportit në përgjithësi.
- Përpilimi i shkresave dhe dhënia e informacioneve subjekte private apo institucione shtetërore për çështje që kanë lidhje me markat tregtare dhe të shërbimit.
- Në bashkëpunim me sektorin juridik përfaqësim i DPPM në çështje të ndryshme gjyqësore.
- Gjatë vitit 2011 janë përgatitur shkresat për marrjen në testim të personave që kishin paraqitur kërkesë për t'u pranuar si përfaqësues të autorizuar të patentave dhe markave.
- Janë marrë në testim 22 persona nga të cilët 5 janë liçensuar dhe kanë marrë provimin si Përfaqësues të autorizuar të patentave dhe markave, ndërsa 17 të tjerë janë liçensuar vetëm si përfaqësues të autorizuar të markave. Mbështetur në kërkesën e tyre 3 persona pasi janë testuar kanë marrë liçencën si përfaqësues të autorizuar të patentave.
- Janë përgatitur fletët e regjistrimit për të gjithë përfaqësuesit e autorizuar të cilët kanë kaluar testimin,etj.

### **3- SEKTORI JURIDIK DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

Sektori Juridik i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Trajnimeve gjatë vitit 2011, në përmbushje të detyrave të tij organike, ka punuar në këto drejtime kryesore:

#### **A. Ndjekja e procedurave dhe përpilimi i akteve ligjore për kërkesat e paraqitura pranë Bordit të Apelimit të DPPM.**

Gjatë vitit 2011, Sektori Juridik ka ndjekur procedurat dhe ka përgatitur njoftimet dhe aktet e tjera ligjore për **42 kërkesa** të paraqitura pranë Bordit të Apelimit të DPPM (6 prej tyre të depozituara në vitin 2010 dhe 36 gjatë vitit 2011) sipas këtyre objekteve:

##### **1. Kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të markave kombëtare**

**25** kërkesa të reja për kundërshtimin e një aplikimi kombëtar për regjistrim marke janë depozituar pranë DPPM gjatë vitit 2011. Sektori juridik ka ndjekur praktikën për këto kërkesa duke përpiluar aktet administrative të parashikuara nga ligji dhe aktet nënligjore në fuqi.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të kërkesave të mësipërme, Bordi i Apelit ka marrë vendim për **19** raste duke vendosur:

- pranimin e kërkesës dhe refuzimin e aplikimit për regjistrim marke në **7** raste:
- rrëzimin e kërkesës dhe vazhdimin e procedurave të regjistrimit të markës në **9** raste
- mospranimin për shqyrtim të kërkesës në **3** raste.

**5** prej vendimeve të Bordit janë apeluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Pranë Bordit të Apelit të DPPM është paraqitur gjithashtu **1** kërkesë për kundërshtimin e patentës së lëshuar, por për shkak të paraqitjes së kërkesës jashtë afateve ligjore, Bordi ka vendosur mospranimin për shqyrtim të saj.

## ***2. Kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të markave ndërkombëtare***

Gjatë vitit 2011 janë depozituar pranë DPPM, **7** kërkesa të reja për kundërshtimin e një aplikimi ndërkombëtar për regjistrim marke, të publikuar në Buletinin e Markave të Zyrës Ndërkombëtare të OBPI (Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale) në bazë të Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit.

Sektori juridik ka ndjekur procedurat ligjore për këto kërkesa duke dërguar pranë Zyrës Ndërkombëtare njoftimet e refuzimit provizor të markave të kundërshtuara.

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të kërkesave të mësipërme, Bordi i Apelit ka marrë vendim në **7** raste (3 kërkesa të vitit 2010 dhe 4 kërkesa të vitit 2011) duke vendosur:

- pranimin e kërkesës dhe refuzimin e aplikimit për regjistrim marke në **6** raste:
- rrëzimin e kërkesës dhe vazhdimin e procedurave të regjistrimit të markës për **1** rast.

Asnjë prej vendimeve të mësipërme të Bordit nuk është apeluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## ***3. Kërkesa për apelimin e vendimit të DPPM për refuzimin e një aplikimi***

Bordi i Apelit të DPPM, përveç kërkesave për kundërshtimin e regjistrimit të markave, disenjove industriale dhe patentave të lëshuara, shqyrton edhe kërkesat për apelimin e vendimit për refuzimin e një aplikimi për patentë/markë/disenjo/tregues gjeografik të marrë nga Sektorët përkatës.

Gjatë vitit 2011, janë depozituar pranë Bordit të Apelit, **3** kërkesa për apelim, 2 prej të cilave janë shqyrtuar prej tij duke u vendosur refuzimi i tyre dhe 1 prej kërkesave është ende në proces.

Vendimet e mësipërme të Bordit nuk janë apeluar në gjykatë.

#### 4. Dinamika e aktivitetit të Bordit të Apelimit të DPPM gjatë periudhës 2008-2010

Bordi i Apelimit është një organ i brendshëm i DPPM i cili krijohet me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm, i cili është edhe kryetar i Bordit. Bordi përbëhet nga 3 anëtarë, njëri prej të cilëve duhet të jetë jurist i Sektorit Juridik të DPPM dhe është përgjegjës për përpilimin e akteve ligjore që lëshon Bordi në bazë të ligjit dhe akteve nënligjore dalë në zbatim të tij.

Bordi ka filluar të funksionojë si një organ administrativ i rëndësishëm për mbrojtjen e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale (patenta, diseno industriale, marka, tregues gjeografikë) në vitin 2008 dhe ka si bazë ligjore për krijimin dhe funksionimin e tij, ligjin nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” dhe rregulloret dalë në zbatim të tij.


Gjatë periudhës 2008-2011, Bordi është konsoliduar si një organ shqyrtimi në nivel administrativ të konflikteve me objekt të drejtat e pronësisë industriale, duke shërbyer si një shkallë e parë dhe shumë e rëndësishme për zgjidhjen e këtyre konflikteve.

Numri gjithmonë në rritje i kërkesave të depozituara për shqyrtim pranë Bordit është tregues i rritjes së ndërgjegjësimit për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale si dhe i rritjes së besimit të mbajtësve të këtyre të drejtave tek gjykimi i drejtë i konflikteve nga Bordi i Apelimit të DPPM.


Tabela e mëposhtme tregon numrin e kërkesave të paraqitura nga viti 2008 deri në vitin 2011 pranë Bordit të Apelimit, të ndara sipas objektit të tyre:

VIT I	KUNDËRSHTI ME Marka Kombëtare	KUNDËRSHTIM E Marka Ndërkombëtare	KUNDËRSHTIM E Patenta	APELIME Marka	APELIM E Patenta	TOTALI
2008	0	0	0	1	22	23
2009	19	2	0	3	0	24
2010	8	13	0	3	1	25
2011	25	7	1	3	0	36

Grafiku i mëposhtëm tregon rritjen në vite të kërkesave të depozituara pranë Bordit të Apelimit të DPPM nga palët e interesuara:



Më poshtë është paraqitur në mënyrë grafike raporti midis kërkesave për kundërshtim të markave kombëtare dhe atyre ndërkombëtare, të paraqitura pranë Bordit të Apelit për shqyrtim për periudhën 2008-2011:



**B. Përfaqësimi i DPPM në çështjet gjyqësore me objekt të drejtat e pronësisë industriale.**

Gjatë vitit 2011, sektori juridik ka përfaqësuar DPPM në çështjet gjyqësore duke paraqitur kërkesa, shpjegime dhe prapsime për **25 çështje gjyqësore** në të cilat DPPM është thirrur si palë e paditur ose person i tretë, nga të cilat:

- **8** çështje kanë pasur si objekt shfuqizimin e një marke të regjistruar, për arsye të cënimit të të drejtave të një marke të mëparshme ;
- **16** çështje kanë pasur si objekt apelimin e një vendimi të Bordit të Apelit të marrë lidhur me kërkesën për kundërshtimin e regjistrimit të një marke të publikuar për shkak të shkeljes së të drejtave të mëparshme (15 çështje) dhe lidhur me kërkesën për rivendosjen në afat të një patente (1 çështje);

- 1 çështje ka pasur si objekt pagimin e një shume parash si rezultat i shfrytëzimit të të drejtave mbi një patentë.

Gykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë gjatë vitit 2011 ka marrë vendim për **13** nga çështjet e sipërpërmendura duke vendosur :

- për **4** nga çështjet me objekt shfuqizimin e një marke të regjistruar, pranimin e padisë në 3 raste dhe rrëzimin e padisë në 1 rast;
- për **8** nga çështjet me objekt apelimin e një vendimi të Bordit të Apelit të DPPM, rrëzimin e padisë dhe lënien në fuqi të vendimit të Bordit në 3 raste, pushimin e padisë për shkak të heqjes dorë të paditësit në 4 raste dhe pranimin e padisë dhe ndryshimin e vendimit të Bordit në 1 rast. Vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të marra gjatë vitit 2011 si më sipër, janë apeluar në Gjykatën e Apelit Tiranë në **9** raste dhe çështjet priten të merren në shqyrtim nga kjo gjykatë gjatë vitit 2012.

#### **C. Mbajtja e korrespondencës me Zyrën Ndërkombëtare të OBPI**

Gjatë vitit 2011 janë dërguar pranë Zyrës Ndërkombëtare të OBPI, njoftimet lidhur me regjistrimet ndërkombëtare si më poshtë:

- Njoftime për refuzimin e plotë provizor për shkak të paraqitjes së një kundërshtimi për **5** regjistrime ndërkombëtare;
- Njoftimi për konfirmimin e refuzimit të plotë provizor për **4** regjistrime ndërkombëtar dhe njoftimi i tërheqjes së refuzimit të plotë provizor për **1** regjistrim ndërkombëtar.
- Në kuadër të forcimit të infrastrukturës së IT së DPPM, ekspertë të EPO kanë bërë një vlerësim të sistemit të IT me qëllim dhënien e asistencës në projekte të ardhshme.

#### **D. Detyra te tjera te kryera nga sektori juridik**

- Përgatitja e raportit të kontributit të qeverisë shqiptare në hartimin e progres raportit të BE për Shqipërinë për vitin 2010, kapitulli 7 (Pronësia Intelektuale) si dhe hartimi i progres-raporteve periodike për Komisionin Evropian, Komitetin e Stabilizim Asociimit dhe takimin e Nënkomitetit BE-Shqipëri për Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën (Prill 2011) në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër në MSA, Dokumentin e Partneritetit dhe PKZMSA në fushën e të drejtave të Pronësisë Industriale dhe që shërbejnë si bazë për përgatitjen e Progres Raportit të BE për Shqipërinë.
- Përgatitja e komenteve dhe sqarimeve lidhur me gjetjet e Raportit Analitik 2010 dhe Progres Raportin 2011 të BE për Shqipërinë në lidhje me Kapitullin 7 (Pronësia Intelektuale).



- Mbajtja e korrespondencës me institucionet e përfshira në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2010-2015 dhe përgatitja e informacioneve dhe raportimeve për iniciativat ligjore dhe aktivitetet zbatuese të ndërmarra nga DPPM në zbatim të kësaj Strategjie.
- Dhënia e kontributit në hartimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera analoge, konkretisht në hartimin e Memorandumit të Bashkëpunimit të DPPM me Zyrën e Pronësisë Industriale të Republikës së Kosovës, memorandum i cili u nënshkrua më datë 07.12.2011.
- Mbajtja e kontakteve dhe dhënia e mbështetjes dhe informacioneve të kërkuara nga grupi i zbatimit të projektit IPA Kombëtare 2009 si dhe përgatitja e raporteve lidhur me zbatimin e projektit, të kërkuara nga METE.
- Përgatitja e raportit të progresit për vitin 2010 në fushën e Pronësisë Industriale në kuadër të Raportit për Politikën Tregtare të OBT.
- Përgatitja e informacionit në kuadër të rishikimit të Ankesit 7 të Marrëveshjes CEFTA lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Industriale të ratifikuara nga shteti shqiptar si dhe përgatitja e raportit të vetvlerësimit për fushën e pronësisë industriale në kuadër të hartimit nga METE të raportit të vetvlerësimit të Politikave Tregtare mbi bazën e Aktit të Biznesit të Vogël (SBA).
- Reflektimi i sugjerimeve të ministrive përkatëse dhe ripërpunimi në bazë të këtyre sugjerimeve i dy projekt-vendimeve të hartuara nga sektori juridik gjatë vitit 2010, të cilët pasi u ripunuan, u paraqitën për shqyrtim dhe miratim pranë Këshillit të Ministrave gjatë vitit 2011. Këto vendime janë: VKM Nr.433 datë 16.06.2011 “Për një ndryshim në VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 për miratimin e tarifave të regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale, i cili hyri në fuqi më 15 Korrik 2011 dhe VKM Nr. 618 datë 07.09.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 “Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, hyrë në fuqi më datë 12 tetor 2011.
- Dhënia e asistencës juridike për Sektorët e Ekzaminimit të Patentave dhe Markave për interpretimin dhe zbatimin e saktë të ligjit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare mbi të cilat bazohet veprimtaria e tyre si dhe vënia në dijeni për aktet e reja ligjore të hyra në fuqi në vitin 2011 konkretisht ndryshimet në tarifën e shërbimeve që ofron DPPM dhe ndryshimet në rregulloren e lëshimit të patentave.
- Përpilimi i shkresave dhe informacioneve të ndryshme gjatë procesit të këmbimit të korrespondencës me subjekte private apo institucione shtetërore për çështje me karakter juridik.
- Plotësimi i formularëve informues të kërkuara nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale lidhur me aspekte të ndryshme në fushën e Pronësisë Industriale.

- Përgatitja e raportit vjetor 2010 dhe e objektivave të Sektorit për vitin 2012.
- Kryerja në IPAS e veprimeve lidhur me aplikimet ndërkombëtare për regjistrimin e markave në bazë të Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit;
- Shpërndarja e korrespondencës së DPPM me institucionet e tjera kombëtare, ndërkombëtare dhe me subjektet që aplikojnë pranë DPPM për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale.

#### **4- SEKTORI I TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT**

Sektori i Teknologjisë së Informacionit ka si objekt të veprimtarisë së tij administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së IT duke bërë të mundur administrimin e automatizimit të procedurave të regjistrimit të Objekteve të Pronësisë Industriale në DPPM. Ky sektor mundëson formatin elektronik të të gjithë objekteve të Pronësisë Industriale si edhe në zbatim të Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, ky sektor bën të mundur përgatitjen e Buletinit të Pronësisë Industriale. Gjithashtu sektori harton politika për përmirësimin e infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit (TI) në DPPM.

Duke konsideruar rëndësinë që Teknologjia e Informacionit ka pasur dhe vazhdon të ketë në sistemin e Administratës Publike dhe nisma kombëtare për e-government, DPPM gjatë 2011 i kushtuar rëndësi përmirësimit të TI.

Gjatë vitit 2011 Sektori i Teknologjisë së Informacionit i ka realizuar detyrat e tij dhe angazhimet e mara në pikat e mëposhtme:

- 1) Hartimi i politikave për përmirësimin e infrastrukturës së TI në DPPM.
- 2) Implementimi i këtyre politikave dhe realizimi në ambientet e punës.
- 3) Administrimi dhe mirëmbajta e sistemit të TI në tërësi.
- 4) Kalimi i të dhënave në format elektronik.
- 5) Realizimi i publikimit të të gjithave Objekteve të Pronësisë Industriale në përputhje me bazën ligjore.

Në hartimin e politikave të përmirësimit të TI gjatë 2011 është bërë një studim i infrastrukturës për të parë pikat në të cilat ka qënë e domosdoshme përmirësimi

Një detyrë kryesore e sektorit të TI është edhe administrimi i sistemit të automatizimit të Pronësisë Industriale (IPAS).

Në Janar 2011 sistemi u konfigurua për procedimin e të gjithë vitit 2011, për arsye se sistemi funksionon me procedime vjetore, ku çdo ditë punë e vitit ka veprimet e bëra në këtë ditë.

Një element shumë i rëndësishëm gjatë vitit 2011 ka qënë instalimi i versionit të ri IPAS Java në Maj 2011. Në datat 23 Maj 2011 deri në 27 Maj 2011, eksperti i WIPO-s instaloi dhe mundësoi një seance trajnimi për instalimin dhe përdorimin e IPAS Java. Në muajt Qershor – Tetor 2011, në mënyrë të vazhdueshme nga sektori i TI është bërë trajnimi i stafit për përdorimin e IPAS Java. Në tetor 2011 nga eksperti i WIPO-s u mundësua instalimi i versionit të ri të IPAS.

Pas ndryshimeve në rregulloren e patentave, sektori i TI ka bërë përshtatjen modeleve të dokumentave zyrtare të lëshuara nga DPPM, duke reflektuar ndryshimet e rregullores.

Sektori i TI në detyrat për funksionimin e IPAS gjatë 2011 ka kryer edhe:

- Back-up i përditshëm për sigurinë e ruajtjes së informacionit.
- Gjenerimi i statistikave të ndryshme gjatë 2011.
- Administrimi i të drejtave të secilit përdorues në përputhje me profilin e punës.
- Kalimi në IPAS i të dhënave bibliografike për 720 aplikime për marka, 354 aplikime për patenta, 17 aplikime për disenjo industriale.
- Janë skanuar elementet figurative të markave dhe dizenjove industriale.
- Janë improtuar në formë elektronike 2887 marka të aplikuara në territorin e Shqipërisë nëpërmjet Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit.

Nga sektori i TI në 2011 është bërë kontroll i përditshëm i sistemit të IT së DPPM i cili ka konsistuar në:

1. Administrim i rrjetit kompjuterik (LAN) dhe siguria e funksionim të këtij rrjeti dhe pajisjeve të instaluar në të.
2. Hostimi nga kompani private në Agjensinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacioni (AKSHI), të faqes zyrtare të DPPM [www.alpto.gov.al](http://www.alpto.gov.al) dhe mail serverit zyrtar.
3. Përditësim i faqes së internetit [www.alpto.gov.al](http://www.alpto.gov.al) në varësi të informacioneve të dërguara nga sektorët përkatës.
4. Ndihmë e stafit në përdorimin e bazës së të dhënave, dhe programeve të ndryshme në funksion të punës.

#### ***PUBLIKIMI I BULETINIT TË PRONËSISË INDUSTRIALE :***

Sektori i TI bën të mundur përgatitjen e Buletinit të Pronësisë Industriale. Në vitin 2011 janë publikuar 3759 rekorde të Objekteve të Pronësisë Industriale të ndara në buletinë si më poshtë.

***“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 31, Dt. 01 Shkurt 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale NR. 31, Dt. 01 Janar 2011 ne te cilin jane publikuar te dhenat bibliografike per 265 rekorde te Objekteve te Pronesise Industriale.

***“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 32, Dt. 01 Mars 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 32, Dt. 01 Shkurt 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 264 rekorde të Objekteve të Pronësisë Industriale

***“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 33, Dt. 01 Pril 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 33, Dt. 01 Mars 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 242 rekorde të Objekteve të Pronësisë Industriale

***“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 34, Dt. 02 Maj 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 34, Dt. 01 Prill 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 300 rekorde të Objekteve të Pronësisë Industriale

***“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 35, Dt. 02 Qershor 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 35, Dt. 02 Maj 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 255 rekorde të Objekteve të Pronësisë Industriale

***“Buletini i Pronësisë Industriale” – Marka dhe “Buletini i Pronësisë Industriale” – Patenta, NR. 36, Dt. 01 Gusht 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 36, Dt. 01 Gusht 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 494 rekorde të Objekteve të Pronësisë Industriale

***“Buletini i Pronësisë Industriale”- Patenta NR. 37, Dt. 01 Shtator 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” – Patenta NR. 37, Dt. 01 Shtator 2011 ne te cilin jane publikuar te dhenat bibliografike per 33 rekorde të Patentave

***“Buletini i Pronësisë Industriale”- Marka NR. 37, Dt. 04 Tetor 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” – Marka NR. 37, Dt. 01 Tetor 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 313 rekorde të markave dhe dizenjove Industriale.

***“Buletini i Pronësisë Industriale”- Patenta NR. 38, Dt. 01 Tetor 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” – Patenta NR. 38, Dt. 01 Shtator 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 64 rekorde të Patentave

***“Buletini i Pronësisë Industriale”- Marka NR. 38, Dt. 02 Dhjetor 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” – Marka NR. 38, Dt. 02 Dhjetor 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 292 rekorde të markave dhe dizenjove Industriale.

***“Buletini i Pronësisë Industriale”- Patenta NR. 39, Dt. 01 Nëntor 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” – Patenta NR. 39, Dt. 01 Nëntor 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 49 rekorde të Patentave

***“Buletini i Pronësisë Industriale”- Patenta të Skaduara NR. 39, Dt. 01 Nëntor 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” – Patenta NR. 39, Dt. 01 Nëntor 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 1068 rekorde të Patentave te skaduara.

***“Buletini i Pronësisë Industriale”- Patenta NR. 40, Dt. 02 Dhjetor 2011***

“Buletini i Pronësisë Industriale” – Patenta NR. 40, Dt. 02 Dhjetor 2011 në të cilin janë publikuar të dhënat bibliografike për 120 rekorde të Patentave.

***Për përgatitjen e statistikave dhe raporteve sektori i TI ka realizuar si më poshtë:***

- Përgatitjen raportit vjetor 2011 për sektorin e TI. Gjenerimin nga IPAS të të dhënave të domosdoshme për raportin vjetor 2011 të sektorëve të tjerë.
- Përgatitjen e raporteve mujore për punën e sektorit të TI gjatë 2011, si edhe të të dhënave sektorëve të tjerë.
- Formatimi i dokumenteve statistikore dhe dokumenteve të tjerë standarde.
- Përgatitjen e raporteve apo statistikave të ndryshme të kërkuara nga eprori.
- Përgjigje kërkesa të ndryshme të depozituara në DPPM të cilat kanë lidhje me sektorin e TI, dhe të deleguara nga eprori.

***Detyra të tjera ndihmëse:***

- Ka marrë pjesë në takime qe kanë të bëjnë me TI.
- Ka assistuar në misionin e WIPO ne lidhje me IPAS në Maj dhe Tetor 2011.

- Ka ndihmuar në mbarëvajtjen e takimeve të organizuara nga DPPM.
- Ka bere te mundur lëshimin e 1040 faturave për arkëtim.
- Ka perfaqesuar DPPM ne 2 Komitete Teknike dhe Operacional të EPO.
- Janë kryer të gjitha veprimet hyrje dalje me magazinën.
- Janë përgatitur përgjigje të shkresave të derguara që kanë lidhje më sektorin e IT.

## **5. SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE, SHERBIMEVE DHE FINANCES**

Si të gjitha institucionet e vendit edhe Drejtoria jonë me sektorët përkatës i është përgjigjur sfidave, që janë shtruar para vendit tonë për integrimin e tij në BE. Si të gjithë sektorët e tjerë edhe sektori i Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve e ka konceptuar punën e vet në përmbushje të detyrave madhore që lidhen me qasjen e DPPM-së në analogji me drejtoritë homologe kryesisht ato në rajon. Orientimet e ardhura nga Ministria e Ekonomisë, Ministria e Integritimit dhe ajo e Financës kanë qenë udhëfytyrues ynë edhe në sektorin e ekonomik të kësaj drejtorie. Hapat e hedhura dhe përvoja e marrë nga pjesëmarrja në takimet në Komitetet e Përhershme në EPO, si dhe komunikimet e vazhdueshme me këtë institucion na kanë ndihmuar në mënyrë të konsiderueshme për të ridimensionuar punën tonë në mënyrë që edhe sektori i financës krahas sektorëve të tjerë të profilizohet e të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin për DPPM si anëtare e EPO-s. Drejtimet kryesore të veprimtarisë së Sektorit të Burimeve Njerëzore, Finances dhe Shërbimeve përgjate vitit kalendarik 2011, kanë ardhur në zbatim të detyrave që ka ky sektor për të përmbushur funksionin e tij brenda DPPM-se. Keto drejtime janë:

- 1- Planifikimi dhe realizimi i buxhetit.
- 2- Bilanci.
- 3- Auditimi.
- 4- Marrdheniet me jashtë në sektorin ekonomik.
- 5- Organizimi i pritjeve të delegacioneve të huaja.
- 6- Ndjekja dhe rakordimi i të ardhurave nga EPO, WIPO si dhe nga aktiviteti kryesor i DPPM, të cilat janë pjesë e Buxhetit të shtetit.
- 7- Kujdesi për shlyerjen e detyrimeve financiare që rrjedhin nga anëtarësimi në WIPO dhe në organizata të tjera nderkombetare , EPO etj.
- 8- Mbledhja e dokumentacionit përkatës për personat e emeruar për here të pare ,si dhe largimin e personelit , në përputhje me legjislacionin në fuqi.

9- Ne bashkepunim me Sektorin Juridik, pergatitja e Vizites ne Kosove e Delegacionit te DPPM, si dhe Pritja ne Tirane ne DPPM , per realizimin e M.bashkepunimit me Zyren e Kosoves.

10- Pergatitja dhe realizimi gjithashtu I vizites se delegacionit te DPPM, ne Zyren homologe maqedone.

11- Pergatitja dhe organizimi I vizites se Presidentit te EPO –s ne Tirane.

12- Zbatimi I vendimeve gjyqesore, per largimet nga puna, permbarues privat,

13- Ekzekutimi I fondeve te investimeve.

**Realizimi I buxhetit te vitit 2011 i shprehur ne shifra :**

**I Shpenzime personeli ( Paga , shperblim, fondi I veçante) 600**

Plan 13.000.000 lek Fakt 12.904.782 lek Realizimi 99 %

**II Sigurim Shoqeror dhe Shendetesor 601**

Plan 2.100.000 lek Fakt 2.019.318 lek Realizimi 96 %

**III Shpenzime , sherbime te ndryshme 602**


Plan 3.500.000 lek Fakt 3.500.000 lek Realizimi 100 %.

**IV Investime 231**

Plan 1.000.000 lek Fakt 974.140 lek Realizimi 97 %

Realizimi I Buxhetit ne total Plan 20.000.000 Fakt 19.398.240 Realizimi 97 %

V Të ardhurat nga aktiviteti kryesor Janar - Dhjetor 100.000.000 lek dhe shpenzimet 19.398240 lekë



Grafiku i mësipërm tregon të ardhurat nga aktiviteti parësor i DPPM, dhe shpenzimet gjatë viteve 2001-2011.

Në Zyrën e protokollit të DPPM janë depozituar 2452 dokumenta që kanë lidhje me patentat e shpikjeve dhe 2303 dokumenta që kanë lidhje me markat tregtare dhe te shërbimit. Në këtë zyrë janë dorëzuar të gjithë dokumentat e lëshuara nga ekzaminueset të cilat më pas i përcillen subjekteve përkatëse.